



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:019229
Datë: 27.11.2024
Numri i dokumentit: 06520172

C-IV-14-4010

Ankuesi

S P- Rahovec

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit për N.SH.”Podrima” (në likuidim)- Rahovec, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 27 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit S P nga Rahoveci .**
- 2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tij kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 14 maj 2014, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ044-0060, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim mbi racionin (shujtën) të paguar në periudhën qershor 2007 deri në qershor 2008, në shumën prej 650.00 Euro nga NSH “Podrima” (në likuidim), Rahovec.

Me 19 nëntor 2024, gjykata lëshoj për ankuesin urdhër për prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike mirëpo në flet kthesën e

pranuar nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala ankuese ” ka vdekur” dhe familjaret refuzojnë pranimin e urdhrin te lëshuar nga kjo gjykatë.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së:

Procesi gjyqësor ndërpritet:

a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;

Ne vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Me 19 nëntor 2024, Gjykata ka tentuar që ankuesit t’ia dërgojë urdhrin për prova shtesë në mbështetje të ankesës së parashtruar, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala “ka vdekur” dhe familja refuzuan pranimin e urdhrin te lëshuar nga kjo gjykatë.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha, Gjyqtare